

VENDIM
Nr.254, datë 27.3.2020

PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURAVE, TË DOKUMENTACIONIT DHE TË MASËS SË PËRFITIMIT TË NDIHMËS FINANCIARE PËR TË PUNËSUARIT NË SUBJEKTET E BIZNESIT ME TË ARDHURA VJETORE DERI 14 MILIONË LEKË, NDIHMËS EKONOMIKE E TË PAGESËS TË SË ARDHURËS NGA PAPUNËSIA GJATË PERIUdhËS SË FATKEQËSISË NATYRORE, TË SHPALLUR SI PASOJË E COVID-19

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, dhe të pikës 5, të nenit 41, të ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtim, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Dhënie ndihme financiare për të punësuarit në subjektet e biznesit me të ardhura vjetore deri 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, për periudhën pas ndërprerjes së aktivitetit ekonomik/marrëdhënieve të punës për shkak të gjendjes së epidemisë së shkaktuar nga COVID-19, sipas urdhrave të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

2. Dhënien e një pagese shtesë për individët që përfitojnë pagesë të ndihmës ekonomike.

3. Dhënien e një pagese shtesë për individët që përfitojnë pagesën e të ardhurës nga papunësia.

II. SUBJEKTET PËRFITUESE, KRITERET DHE DOKUMENTACIONI PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS FINANCIARE PËR TË PUNËSUARIT NË BIZNESET ME TË ARDHURA DERI 14 MILIONË LEKË NË VIT

1. Ndihma financiare për të vetëpunësuarit/të punësuarit llogaritet dhe jepet sipas listëpagesave të deklaruara nga subjektet tatimpaguese. Për ato subjekte, të cilat i deklarojnë listëpagesat çdo tremujor, merret në konsideratë listëpagesa e tremujorit të fundit të vitit 2019, ndërsa për subjektet, të cilat i deklarojnë listëpagesat çdo muaj, merret në konsideratë listëpagesa e muajit janar 2020. Listëpagesat përditësohen me ndryshimet e deklaruara sipas formularit ESig-27, deri në datën e mbylljes së veprimtarisë.

2. Aplikimi për të përfutuar ndihmë financiare bëhet nga subjekti i të vetëpunësuarit/punësuarit. Individët, të cilët janë në më tepër se një listëpagesë, kur të dy aktivitetet janë të mbyllur si pasojë e masave shtrënguese, përfitojnë si ndihmë financiare vetëm një pagë minimale.

Në rastin kur vetëm një prej aktiviteteve rezulton i lejuar, individi, i cili është në më tepër se një listëpagesë, nuk e përfiton ndihmën financiare të pagës minimale.

3. Përfituesit e ndihmës financiare janë individët e vetëpunësuar/punësuar në subjektet me të ardhura vjetore deri në 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë, sipas kategorizimit të mëposhtëm:

a) Personat fizikë të vetëpunësuar;

- b) Punonjësit e papaguar të familjes të personit fizik tregtar;
- c) Të punësuarit në personat fizikë tregtarë;
- ç) Të punësuarit në personat juridikë.

(Ndryshuar me vendimin Nr. 284, datë 10.4.2020, Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 65, datë 13.04.2020.)

4. Për të përfituar ndihma financiare, duhet që subjekti tatimpagues:

- a) të ketë ndërprerë aktivitetin në zbatim të urdhrave përkatës të ministrit të Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale (MSHMS), të nxjerra për këtë qëllim;
- b) të ketë përgjegjësi tatimore për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin dhe tatimin mbi fitimin;
- c) të ardhurat e deklaruara të të cilit, sipas deklaratës së tatimit mbi fitimin/tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, për vitin 2019, të jenë deri 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë.

5. Subjektet, që plotësojnë kushtet sipas pikës 4, të këtij kreu, duhet të paraqesin pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, nëpërmjet portalit e-filinig, kërkesën me të dhënat e përfituesve sipas pikës 3, të këtij kreu, ku përfshihen:

- a) Të dhënat identifikuese të subjektit tatimpagues të pajisur me NIUS;
- b) Të dhënat identifikuese të përfituesve, përfshirë të vetëpunësuarit, punonjësit e papaguar të familjes dhe të punësuarit, përfshirë:
 - i. emrin, atësinë, mbiemrin;
 - ii. numrin personal të identifikimit të përfituesit;
 - iii. bankën ku përfituesi ka llogarinë rrjedhëse bankare;
 - iv. numrin e llogarisë bankare.

6. Nuk përfitojnë ndihmë financiare individët e vetëpunësuar/punësuar, të cilët kanë realizuar për vitin 2019 të ardhura bruto nga paga mbi 2 000 000 (dy milionë) lekë.

(Shtuar me vendimin Nr. 284, datë 10.4.2020, Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 65, datë 13.04.2020.)

III. PROCEDURA E VERIFIKIMIT PËR PËRFITIMIN E NDIHMËS FINANCIARE

1. Strukturat e drejtorive rajonale tatimore bëjnë verifikimet dhe identifikojnë aplikuesit dhe të dhënat në kërkesën e tyre, brenda 10 (dhjetë) ditëve të para të muajit pasardhës, duke analizuar:

- a) tatimpaguesin dhe veprimtarinë e tij, duke verifikuar nëse bën pjesë në listën e veprimtarive që përfitojnë ndihmën financiare;
- b) deklaratimet e bëra dhe pagesat e kryera për tatimet dhe kontributet;
- c) krahasimisht listën e paraqitur për përfitim ndihme me listëpagesën e dorëzuar në mënyrë elektronike dhe detyrimet e paguara;
- ç) të ardhurat e realizuara nga subjekti për vitin 2019.

2. Me qëllim shmangien e abuzimit, strukturat e administratës tatimore, duke përdorur analizën e riskut, mund të kryejnë edhe verifikime në subjektet përfituese për të verifikuar nëse janë të mbyllura.

3. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve i paraqet Drejtorisë së Përgjithshme të Thesarit listën përmbledhëse të individëve përfitues të ndihmës financiare për bankën përkatëse, me të dhënat e mëposhtme:

- a) emrin, atësinë, mbiemrin, numrin e telefonit, e-mailin;
- b) numrin personal të identifikimit të përfituesit;

c) bankën ku përfituesi ka llogarinë rrjedhëse bankare;

ç) numrin e llogarisë bankare.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Thesarit kryen pagesat për individët, përfitues sipas këtij vendimi.

5. Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve ruan dhe administron dokumentacionin e përcaktuar në pikën 5, të kreut II, dhe në pikat 1-3, të kreut III, të këtij vendimi, sipas dispozitave ligjore e nënligjore të parashikuara për ruajtjen e dokumentacionit dhe arkivat.

6. Drejtori i Përgjithshëm i Tatimeve miraton rregullat procedurale për mënyrën e bashkëpunimit me drejtoritë rajonale, institucionet përgjegjëse si dhe procedurat e kalimit në thesar të ndihmës financiare dhe njoftimin e subjekteve përfituese.

IV. MASA E NDIHMËS FINANCIARE, EKONOMIKE DHE E PAGESËS TË SË ARDHURËS NGA PAPUNËSIA

1. Ndihma financiare, që përfitojnë të vetëpunësuarit, punëtorët e papaguar të familjes dhe të punësuarit sipas këtij vendimi, është e barabartë me pagën minimale në fuqi, 26 000 (njëzet e gjashtë mijë) lekë në muaj, e miratuar me vendim të Këshillit të Ministrave.

2. Pagesa e ndihmës ekonomike për subjektet përfituese, sipas vendimit nr.597, datë 4.9.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e procedurave, të dokumentacionit dhe të masës mujore të përfitimit të ndihmës ekonomike dhe përdorimit të fondit shtesë mbi fondin e kushtëzuar për ndihmën ekonomike”, që rezultojnë përfitues të ndihmës ekonomike ose kanë aplikuar për të përpara datës 10 mars, do të jetë sa dyfishi i shumës së llogaritur sipas vendimit të sipërpërmendur.

3. Pagesa e së ardhurës nga papunësia për subjektet përfituese sipas vendimit nr.161, datë 21.3.2018, të Këshillit të Ministrave, “Për pagesën e së ardhurës nga papunësia”, që rezultojnë përfitues të pagesës të së ardhurës nga papunësia ose kanë aplikuar për të përpara datës 10 mars 2020, do të jetë sa dyfishi i shumës së llogaritur sipas vendimit të sipërpërmendur.

4. Verifikimi, llogaritja dhe shpërndarja për përfituesit sipas pikave 2 dhe 3, të kreut IV, do të bëhet sipas procedurave të dokumentimit e të shpërndarjes nga institucionet e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi.

V. ÇËSHTJE TË FUNDIT

1. Efektet financiare, në masën **6 416 000 000 (gjashtë miliardë e katërqind e gjashtëmbëdhjetë milionë) lekë**, do të përballohen nga zëri “Kontingjenca për paketën sociale anti-COVID”, miratuar në buxhetin e shtetit, për vitin 2020.

(Ndryshuar me vendimin Nr. 284, datë 10.4.2020, Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 65, datë 13.04.2020.)

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Agjencia Kombëtare për Punësim dhe Aftësi (AKPA) dhe Shërbimi Social Shtetëror për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet nga data 1 prill 2020 deri në përfundim të gjendjes së epidemisë nga COVID-19, por jo më shumë se 3 (tre) muaj.

KRYEMINISTËR
Edi Rama

KËRKESË PËR PËRFITIM TË NDIHMËS FINANCIARE

I vetëpunësuar (emër atësi mbiemër)/Personi Juridik _____
NUIS (NIPT-i) _____
Drejtoria Rajonale Tatimore _____
Nr. Telefoni _____
Adresë e-mail-i _____

LISTA E PUNONJËSVE PËRFITUES TË SUBJEKTIT (I VETËPUNËSUARI, PUNONJËSIT E PAPAGUAR TË FAMILJES DHE TË PUNËSUARIT) PËR PERIUdhën: _____

Nr.	Emri, atësia, mbiemri	Numri personal (NID)	Banka e nivelit të dytë ku ka llogarinë	Numuri i llogarisë bankare
1				
2				
3				
4				
5				
6				

Kujdes: nga kjo ndihmë financiare përfitojnë vetëm të vetëpunësuarit/punonjësit e papaguar të familjes, të punësuarit të subjekteve tatimpaguese të regjistruara në organet tatimore dhe që ushtrojnë veprimtari ekonomike apo aktivitete të cilat janë mbyllur për shkak të situatës së emergjencës si pasojë e përhapjes së virusit Covid-19. Subjektet tatimpaguese të regjistruara duhet të kenë përgjegjësi tatimore për tatimin e thjeshtuar mbi fitimin dhe tatimin mbi fitimin dhe të kenë deklaruar për vitin 2019 të ardhura deri në 14 000 000 (katërmëdhjetë milionë) lekë.

Emri Mbiemri _____

Datë _____

Firma _____

Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 53, datë 27.03.2020

Ndryshuar me vendimin Nr. 284, datë 10.4.2020, Botuar në Fletoren Zyrtare Nr. 65, datë 13.04.2020.